

Neelusti - JENI MËHALLA

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, nenit 3, alineja 1, pika (b) të Rregullores nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 19, alineja 1, pika 2 dhe të nenit 39, alineja 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 shtator 2007, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për një pjesë të lagjes “Jeni Mëhalla” të Prizrenit

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së për një pjesë të lagjes “Jeni Mëhalla” të Prizrenit, e cila ofrohet si donacion prej byrosë projektuese të hartuar nga NPN “ALBING”, nga Prizreni (bartës i hartimit të Planit), e njëjta e hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike përmban:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban për një pjesë të lagjes “Jeni Mëhalla të Prizrenit përfshihen këto ngastra kadastrale: nr. 1142/1; 1142/3; 1142/2; 1194; 1195; 1196; 1197/4; 1197/3; 1197/9; 1197/5; 1197/6; 1197/7; 1197/8, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2,59 ha.

Me Planin Zhvillimor Urban për këtë lokacion është i definuar ndërtim të lartë.

Neni 3

Plani Rregullues Urban – një pjesë të lagjes “Jeni Mëhalla, përfshin lokacionin që përkufizohet me rrugët: “De Rada”; “Gjeravica”; “Reshat Karjagdiu”; “Shote Galica” dhe “Latif Berisha”.

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin

e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'u mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe zbatimin e të njëjtës do të bëhet në pajtim me PZHU-në.

Neni 5

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 6

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, alineja 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit dhe zbatimin e të njëjtës do të bëhet në pajtim me PZHU-në.


Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Çështjeve Pronësore-Juridike dhe Drejtoria e Gjeodezisë dhe e Kadastrës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

KUVENDI KOMUNAL
Asambleja Komunale
Nr. 01/011-65
Më 27 shtator 2007
Prizren



Kryetari i Kuvendit
Mr. Hajrullah Kryeziu